



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1228 Prot.

Tiranë, më 05.12 2016

VENDIM Nr. 131, datë 22.11.2016

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 13 të datës 22.11.2016, pasi shqyrtoi Kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KKA, Nr. 123, datë 25.10.2016, për projektin "*Projektim dhe Mbikëqyrje e ndërhyrjes në sistemin e kanalizimeve të ujërave të ndotura të Durrësit*", -subjekti *Drejtoria e Përgjithëshme e Ujësjellës Kanalizimeve*" Durrës, kërkuar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve,

VENDOSI:

1. Të depozitohet pranë ASHA projekti, i cili mundëson spostimin e kanalit të ujërave të ndotura për traktin 6, i cili pozicionohet në zonën arkeologjike "A" të qytetit të Durrësit si dhe propozimet në lidhje me traktet e tjera Nr.2, Nr.4 dhe Nr. 12, të cilat pozicionohen në zonën arkeologjike "B" të këtij qyteti. Ky projekt do të kalojë për shqyrtim në KKA e radhës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO